

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6975
E hënë, 21 gusht 2023
Çmimi 0.40

Vagonët e ndryshkur shndërrohen në kënd lojërash



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DOSJA E PROKURORISË: 52.5 TONË GRURË, 200 MIJË LITRA VAJ DHE 120 MIJË KG SHEQER NUK ERDHËN NË KOSOVË

KURTI ME QEVERITARË DHE BASHKËPARTIAKË LËSHOHEN NË AKUZA NDAJ GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE



Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) i ka dënuar ashpër deklaratat e kryeministrit Albin Kurti për prokurorët dhe gjykatësit "e korruptuar të elitës së vjetër", pas arrestimit të dy zyrtarëve të

Ministrit të Industrisë nën dyshimin për keqpërdorim të rezervave shtetërore më 18 gusht. Këshilli Prokurorial i ka bërë thirrje Kurtit t'i ndalë "shantazhet" ndaj prokurorëve dhe gjykatësve.

Ndërkaq partitë opozitare kanë theksuar se në demokracitë e konsoliduara asnjëherë nuk kanë dëgjuar që udhëheqësit e shtetit t'i ofendojnë gjyqtarët dhe prokurorët e tyre

ALBANOLOGJIA, MË PAK STUDENTË VENDËS DHE INTERESIM TË MADH NDËRKOMBËTAR



FSHATI STUDIME E POSHTME HARROHET NGA PUSHTETI LOKAL, VIZITOHET VETËM KUR KA FUSHATË ZGJEDHORE



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



GRECIA E VAZHDON LUFTËN ME ZJARRET MIDIS TEMPERATURAVE TË LARTA

RRËZOHET NË HËNË ANIJA KOZMIKE E RUSISË, LUNA-25

RRITET PËR 10 PËR QIND NUMRI I TË PREKURVE ME KANCER TË GJIRIT BRENDË 7 MUAJVE NË KOSOVË



EKONOMI



MBYLLET NJË MUAJ PARA KOHE AFATI PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONIMIN E IZOLIMIT TË SHTËPIVE

EKONOMI



MALISHEVA E BALLKANI DOMINOJNË SUPERLIGËN

Greçia e vazhdon luftën me zjarret midis temperaturave të larta

ATHINË, 20 GUSHT - Zjarret në shkurre dhe në pyje të mëdha janë duke dalë nga kontrolli në verilindje të Greçisë për shkak të temperaturave të larta, erërave të forta dhe një thatësire që po zgjat me javë të tëra. Flaka ka arritur nëpër fshatra në rajonin e qytetit të portit, Aleksandropolis, të dielën, duke i dëmtuar shumë shtëpi dhe toka bujqësore, thanë autoritetet vendore. Zjarri u ndez të shtunën. Zjarrfikësit kanë përdorur aeroplanë dhe helikopterë për shuarjen e zjarrit në mënyrë që ta

mbajnë nën kontroll zjarrin të dielën, thanë zyrtarët grekë. "Ishte një natë shumë e vështirë", tha kryetari i Aleksandropolis, Giannis Zamboukis, për radion shtetërore. Ai tha se tetë fshatra afër qytetit janë evakuuar plotësisht. Katër njerëz u dërguan në spital për shkak të telasheve me frymëmarrjen, shtoi ai. Atraksionet turistike nuk janë në rrezik, sipas tij. Nuk është e qartë se çfarë i shkaktoi zjarret, por ato u përhapën shpejt, të ndihmuara

nga erërat e forta dhe thatësira e vazhdueshme. Në përgjithësi, 46 zjarre pylli dhe shkurreje u ndezën në gjithë vendin të shtunën, tha brigada e zjarrfikësve. Shërbimi Civil i Greçisë e publikoi një hartë të dielën, duke treguar se shkalla e dytë më e lartë e rrezikut për zjarre vlen për shumë pjesë të Greçisë. Temperaturat në Greçi këto ditë shënojnë 39 gradë celsius dhe pritet të vazhdojnë njëjtë edhe në ditët në vijim, tha Zyra e Meteorologjisë.



Rrëzohet në Hënë anija kozmike e Ruisë, Luna-25

MOSKË, 20 GUSHT - Anija kozmike e Ruisë, Luna-25, është rrëzuar në sipërfaqen e Hënës më 20 gusht, pasi e kishte humbur kontrollin, tha Agjencia ruse e Hapësirës, Roskosmos. Ajo pritej të zbarkonte në polin jugor të Hënës, por dështoi pasi hasi në telashe derisa po lëvizte në orbitën e parazbarkimit. Ky ishte misioni i parë i Ruisë në Hënë në 47 vjetet e fundit. Anija kozmike ishte paraparë të zbarkonte të hënën për ta eksploruar një pjesë të Hënës, për të cilën shkencëtarët mendojnë se mund të përmbajë ujë të ngrirë dhe elemente të çmuara.



Roskosmos theksoi të dielën se i kishte humbur të gjitha kontaktet me anijen kozmike të shtunën pasdite. "Mjeti lëvizti në

një orbitë të paparashikuar dhe u shua si pasojë e përplasjes në sipërfaqen e Hënës", tha Roskosmos në një komunikatë për medie më 20 gusht. Të shtunën anija kozmike e përjetoi një "situatë të pazakontë" derisa po përgatitej për t'u futur në orbitën e parazbarkimit, para uljes së paraparë në sipërfaqen hënore më 21 gusht. Sipas medieve ruse, zyrtarët e Hapësirës mbajtën një takim emergjent gjatë natës së 19-20 gushtit, në përpjekje për ta shpëtuar misionin. Luna-25 u fut në orbitën hënore më 16 gusht, duke u bërë anija e

parë kozmike ruse që e bën këtë që nga Luna-24 e liderit sovjetik Leonid Brezhnev në vitin 1976. Rusia synon ta ndërtojë një bazë në Hënë deri në vitin 2040. Luna-25 u nis nga kozmodromi i Ruisë, Vostochny, më 11 gusht, ndërsa në orbitë u fut pesë ditë më vonë, më 16 gusht. Ajo ishte paraparë të vepronte për një vit përreth polin jugor të Hënës. Misioni i saj kishte për qëllim të eksploronte pjesë të Hënës, për të cilat shkencëtarët besojnë se mund të përmbajnë ujë të ngrirë dhe resurse të tjera, të cilat mund të përdoren gjatë qëndrimeve më të gjata të njerëzve në sipërfaqen e Hënës.

Lideri i puçit në Niger thotë se synon qeveri transitore

ABUJA, 20 GUSHT - Lideri i puçit në Niger, Abdourahmane Tchiani, ka thënë të dielën se dëshiron të krijojë qeveri transitore e cila do të mbetet në pushtet për "jo më shumë se tri vjet". Gjatë një fjalimi në televizionin shtetëror më 20 gusht, Tchiani, po ashtu, i paralajmëroi shtetet e huaja kundër ndërhyrjes ushtarake në Niger. Ai tha se dëshiron të ketë "dialog kombëtar gjithëpërfshirës" brenda 30 ditëve dhe të konsultohet me të gjithë qytetarët e Nigerit. Tchiani u bë lider i Nigerit muajin e kaluar, pas një grushtshteti tronditës, gjatë të cilit garda presidenciale e arrestoi dhe e rrëzoi nga pushteti presidentin e zgjedhur në mënyrë demokratike, Mohamed Bazoum. Dialogu kombëtar do ta ofronte bazën për krijimin e një kushtetute të re, tha Tchiani, duke nënvizuar se vendimet do të merren "pa

ndërhyrje të jashtme". Komentet e tij vijnë pasi blloku rajonal i Afrikës Perëndimore, i njohur si ECOWAS, tha se shefat e mbrojtjes së tij janë duke e përgatitur një plan për ndërhyrje ushtarake në Niger, nëse nuk kthehen rendi dhe ligji. Data e mundshme e ndërhyrjes është caktuar, por nuk është bërë publike, ka thënë ECOWAS. Liderët e rinj të Nigerit u përgjigjën duke thënë se e kanë zhvilluar një strategji mbrojtëse me "masa konkrete" bashkë me dy shtetet fqinje, Malin dhe Burkina Fason, nëse ECOWAS-i vendos të "shkojë në luftë". Mali dhe Burkina Faso sundohen nga ushtria, po ashtu, pas puçeve. Megjithatë, ECOWAS-i ka theksuar se zgjidhja paqësore duhet të mbetet prioritet dhe se ndërhyrja ushtarake do të ishte e nevojshme vetëm nëse ajo dështon.



Pas grushtshtetit në Niger më 26 korrik, ECOWAS-i bëri thirrje për kthimin e Bazoumit në pushtet, i cili po mbahet në arrest shtëpiak në pallatin

presidencial. Nigeri, një vend i Sahelit me rreth 26 milionë banorë, është një nga shtetet më të varfra në botë.

Deri para grushtshtetit Nigeri ishte një prej partnerëve më demokratik i Shteteve të Bashkuara dhe Evropës në rajonin e Sahelit.

Albanologjia, më pak studentë vendës dhe interesim të madh ndërkombëtar

PRISHTINË, 20 GUSHT - Numri i të huajve të interesuar që ta mësojnë gjuhën shqipe dhe të studiojnë në fushat e albanologjisë është në rritje, ndërkohë që interesimi i të rinjve në Kosovë për ta studiuar gjuhën ose letërsinë shqipe është duke rënë në vazhdimësi, thonë zyrtarë të Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Interesimin e të huajve e dëshmon numri i 120 pjesëmarrësve në kurset e gjuhës shqipe në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, edicioni i 41-t i të cilit është duke u mbajtur aktualisht në Prishtinë, thotë Bardh Rugova, drejtor i seminarit dhe udhëheqës i Departamentit të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filologjisë në UP.

Por, numri prej 20 konkurrentëve, të paraqitur në afatin e parë të pranimit të studentëve në Degën e Gjuhës Shqipe në këtë fakultet, si dhe numri prej gjashtë konkurrentësh të paraqitur në degën e Letërsisë Shqipe, është paralajmërim i mungesës së interesimit për të studiuar në këto dy fusha të albanologjisë, thotë Lindita Sejdiu-Rugova, dekane e Fakultetit të Filologjisë. Rënia e numrit të studentëve në këto dy departamente është evidentuar vit pas viti.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) thotë se është e gatshme të mbështesë përpjekjet e departamenteve të caktuara për tërheqjen e studentëve të rinj.

Gjuha shqipe, "pasuri e madhe"

Leo Sokoliq është nga kryeqyteti sloven, Lubjana. Ai ka ardhur për herë të parë në Kosovë për të marrë pjesë në kurset e gjuhës shqipe që organizohen në kuadër të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Ai thotë se edhe më herët ka ndjekur kurset e gjuhës shqipe në Lubjanë, por seminari në Prishtinë, sipas tij, i jep mundësinë e komunikimit të përditshëm në shqip. "Gjuha shqipe është shumë antike, shumë e vjetër. Unë jam shumë i kënaqur që mund të mësoj, që mund të jem këtu dhe që mund të kuptoj pak, të flas me njerëz. Mendoj se [sërish] do të kthehem këtu, në seminar", thotë Sokoliq për "Radion Evropa e Lirë".

Anja Zhivkoviq është nga Leskovci i Serbisë. Ajo ka përfunduar studimet për gjuhën shqipe në Beograd, ku edhe ka hapur kurset për mësimin e kësaj gjuhe. Siç thotë ajo, në seminarin në Prishtinë, është për herë të pestë dhe vjen për të



përditësuar dijen e saj për gjuhën shqipe. "Më pëlqen, sepse është gjuhë krejt ndryshe nga të gjitha gjuhët që kam mësuar, sepse i flas disa. Është vërtetë një gjuhë shumë interesante për t'u hulumtuar. Është një pasuri shumë e madhe që ju e kenë këtë gjuhë, di dhe dialektet dhe nëndialektet që janë më interesante se sa vet gjuha letrare", thotë Zhivkoviq në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë".

Interesimi i të huajve për shqipen, më i madh sesa i vendësve

Bardh Rugova, drejtor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, thotë se në edicionin e sivjetmë janë pranuar 120 seminaristë dhe po aq nuk kanë arritur të vijnë për shkak të mundësive të kufizuara që ka seminari. Sipas tij, interesimi i të huajve për ta mësuar shqipen është shumë i madh. "Ka interese nga vendet e rajonit dhe ka në departamentet e ndryshme [në universitetet e huaj] në të cilat mësohet shqipja. Problematike është se ne nuk jemi përgjigjur, si shoqëri, ndaj këtyre kërkesave, për të dërguar mësimdhënës në ato katedra. Vetëm gjatë viteve të fundit janë hapur katedra të shqipes në Universitetin e Pragës, në Universitetin e Budapestit dhe në Universitetin e Poznanit. Dhe asnjë prej këtyre qendrave, nuk ka ndonjë mësimdhënës nga Kosova", thotë Bardh Rugova. Megjithatë, siç thotë ai, interesimi i studentëve vendas për të studiuar gjuhën ose letërsinë shqipe është në rënie për vite me radhë. Sipas kriterëve të caktuara nga

Agjencia e Kosovës për Akreditim, numri i studentëve që mund të pranojnë Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe ai i Letërsisë Shqipe është 60.

Në vitin akademik 2022/2023 në Departamentin e Gjuhës Shqipe janë regjistruar 41 studentë, ndërkaq 34 në atë të Letërsisë Shqipe. "Në qoftë se do të kemi një trend të tillë, në rënie, atëherë mund të ketë vështirësi, mund të ketë probleme për ndonjërin prej katedrave [departamenteve]", thotë Bardh Rugova, drejtues i Departamentit të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filologjisë.

Një nga shkaqet e numrit të vogël të studentëve në këto dy departamente, sipas tij, është se kualifikimi aty nuk u siguron mundësinë e punësimit si mësimdhënës në nivelin e arsimit fillor ose të mesëm.

Kualifikimi për mësimdhënës arrihet në Fakultetin e Edukimit dhe sipas Bardh Rugovës, një numër i studentëve orientohen në këtë fakultet për të studiuar lëmin e njëjtë, ndonëse me program më të kufizuar.

Aktualisht, sipas tij, në Kosovë ka rreth 2.000 arsimtarë të gjuhës dhe letërsisë shqipe për shkollat fillore dhe rreth 600 profesorë të kësaj lënde për shkollat e mesme.

Në këtë kontekst, ai thotë se kuadrot që dalin nga Universiteti i Prishtinës, në tërësi, janë më shumë sesa ka nevojë tregu i punës.

Strategji të reja për ruajtjen e departamenteve?

Lindita Sejdiu-Rugova, dekane e Fakultetit të Filologjisë, thotë e studimet në Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe në atë të

Letërsisë Shqipe, megjithatë kualifikojë profile profesionale për të cilat tregu i punësimit ka nevojë. "Nuk ka nevojë të bëhen vetëm mësimdhënës. Mund të bëhesh përkthyes në shqip, nëse e di edhe gjuhë të huaja - pra përkthyes i letërsisë nga gjuhët e huaja në shqip. Mund të punojnë nëpër arkiva. Mendoj që institucionet kanë nevojë më shumë se kurrë për lektorë. Sidomos nëpër media dhe nëpër institucione shtetërore kanë nevojë për lekturimin e dokumentacionit zyrtar", thotë Lindita Sejdiu-Rugova.

Ajo thotë se përgjithësisht ekziston një ulje e trendit të të interesuarve për studime në departamentet, siç i cilëson ajo, "të vogla", siç janë edhe të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe.

Por, siç thekson Sejdiu-Rugova, është e papranueshme që këto dy departamente të studimeve të fushës së albanologjisë, të sillen buzë mbylljes. "Unë nuk dua dhe nuk mundem ta besoj këtë gjë, ndonëse ka rrezik gjithmonë për një gjë të tillë, për çdo katedër. Nuk mendoj që shteti ynë ia lejon vetes që të thotë 'po mbyllet albanologjia'. Kjo nuk guxon të ndodhë", thotë dekanja e Fakultetit të Filologjisë.

Ajo shpreh mendimin se duhet gjetur mënyra dhe strategji që t'i bëjnë më tërheqëse Departamentet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Sipas saj, Universiteti i Prishtinës, tashmë ka nisur të japë bursa për studentë të jashtëm, të cilët dëshirojnë të studiojnë në këtë universitet. Lindita Sejdiu-Rugova konsideron se një formë e tillë stimulimi duhet të bëhet edhe për tërheqjen e studentëve vendas në departamentet sikurse ai i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqipe. "Ne duhet të mendojmë

për strategji dhe mënyra tjera. Duhet të mendojmë ndoshta për shkrirje e të dyjave [departamenteve] gjuhës dhe letërsisë bashkë, ndoshta të krijojmë programe ndërdisiplinare. Ka ide, por mendoj se ato janë resurset apo idetë e fundit. Unë mendoj se do të kemi prapë studentë", thotë Lindita Sejdiu-Rugova.

Ajo thekson se shqetësimet lidhur me interesimin e vogël për studime në Departamentin e Gjuhës dhe në atë të Letërsisë Shqipe i ka shprehur edhe në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, por edhe në dikasterin qeveritar për arsim.

Ministra e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, thekson se është në dijeni lidhur me "numrin e studentëve të regjistruar në afatin e parë në Universitetin e Prishtinës" dhe se rastet sikurse Departamenti i Gjuhës, por edhe ai i Letërsisë Shqipe "janë shumë me interes dhe duhet t'u kushtohet rëndësi e veçantë".

Kjo ministri, në një përgjigje me shkrim për Radion Evropa e Lirë, thotë se bashkë me Fakultetin e Filologjisë dhe Universitetin e Prishtinës, është në pritje të afatit të dytë të regjistrimit për të parë nëse do të ketë rritje të numrit të studentëve të interesuar. "Njëkohësisht, jemi duke shikuar mundësitë për politika afirmative që sigurojnë numër të nevojshëm të studentëve por edhe cilësi në universitet", thuhet në përgjigjen e MASHTI-t.

Nga kjo ministri theksuan se Universiteti i Prishtinës ka buxhet të mjaftueshëm "që të shqyrtojë këto programe të veçanta, por nuk do të mungojë edhe mbështetja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit".



DOSJA E PROKURORISË: 52.5 TONË GRURË, 200 MIJË LITRA VAJ DHE 120 MIJË KG SHEQER
NUK ERDHËN NË KOSOVË

Kurti me qeveritarë dhe bashkëpartiakë lëshohen në akuza ndaj gjykatësve dhe prokurorëve

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) i ka dënuar ashpër deklaratat e kryeministrit Albin Kurti për prokurorët dhe gjykatësit “e korruptuar të elitës së vjetër”, pas arrestimit të dy zyrtarëve të Ministrisë së Industrisë nën dyshimin për keqpërdorim të rezervave shtetërore më 18 gusht. Këshilli Prokurorial i ka bërë thirrje Kurtit t’i ndalë “shantazhet” ndaj prokurorëve dhe gjykatësve. Ndërkaq partitë opozitare kanë theksuar se në demokracitë e konsoliduara asnjëherë nuk kanë dëgjuar që udhëheqësit e shtetit t’i ofendojnë gjyqtarët dhe prokurorët e tyre

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 GUSHT - Këshilli Prokurorial i Kosovës i ka dënuar ashpër deklaratat e kryeministrit Albin Kurti, i cili i ka akuzuar gjykatësit e prokurorët për mbështetje të krimit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, akuzoi “elitën e vjetër dhe të korruptuar politike, gjykatësit e prokurorët e saj dhe mediet e keqpërdoruar për mbështetje të krimit”, për përpjekje për ta kthyer “ish-sistemin e kalbur e të korruptuar”, pas arrestimit të tre personave të akuzuar për keqpërdorim të rezervave shtetërore.

Këshilli Prokurorial i quajti deklaratat e kryeministrit tendencioze, të pavërteta e linçuese ndaj institucionit të prokurorisë dhe prokurorëve të saj. “I bëjmë thirrje kryeministrit dhe ministrave

të kabinetit të tij qeveritar, që të përmbahen nga deklaratat e vazhdueshme shantazhuese dhe rrjedhimisht nënçmuese ndaj sistemit prokurorial të Kosovës në përgjithësi dhe ndaj punës së prokurorëve në veçanti, duke tentuar të linçojnë publikisht çdo gjë që ka të bëjë me sistemin prokurorial dhe punën e prokurorëve të shtetit”, thuhet në reagimin e Këshillit Prokurorial, ku nënvizohet se sulmi dhe linçimi i kryeprokurorit dhe prokurorëve me emra dhe mbiemra është shkelje e patolerueshme dhe tentativë e dështuar për të ndërhyrë në punën e pavarur të Prokurorit të Shtetit.

Këshilli Prokurorial tha në reagim se dënon keqpërdorimin e fjalës së lirë nga ana e kryeministrit dhe ministrave të tij, duke theksuar se “këto deklarata janë krejt të kota ndaj Prokurorit të Shtetit, i cili nuk

ndikohet nga qarqet politike dhe grupet e interesit, por si institucion i pavarur dhe i paanshëm në ushtrimin e mandatit të vet do t’i shkojë deri në fund çdo rasti me dyshim për keqpërdorim të parasë publike dhe në dëm të qytetarëve të Kosovës, pavarësisht kush është, në çka beson dhe çfarë ka bërë”.

Gjykata Themelore e Prishtinës ua caktoi të shtunën masën e paraburgimit prej 30 ditësh tre personave të arrestuar të premtën nën dyshimet për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Mes tyre janë dy zyrtarë ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, Hafiz Gara, drejtor për Rezervat Shtetërore dhe Irfan Lipovica, drejtor në Departamentin për Integrim Evropian, i cili më parë ishte sekretar në këtë ministri. I arrestuari i tretë, sipas medias lokale, është afaristi Ridvan Muharremi, mik i ngushtë i Kurit.

Aksioni i autoriteteve të rendit në MINT vjen pas publikimeve të disa audioincizimeve nga portali “Nacionale”, ku zyrtarët e kësaj ministrie pretendojnë se vaji i kontraktuar dhe i paguar në Poloni për rezervat shtetërore të Kosovës nuk mbërriti kurrë. Sipas audioincizimeve, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me rezervat e grurit. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka mohuar dyshimet për keqpërdorime të rezervave shtetërore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Ai tha se “97 për qind e vlerës së blerë vitin e kaluar ka mbërritur në Kosovë, përfshirë këtu 99,5 për qind të sasisë së grurit që tashmë ndodhet në depo në vendin tonë, e për pjesën e mbetur kompanitë furnizuese kanë obligim të hapur për ta përmbushur kontratën, e nëse nuk e bëjnë këtë, janë procedurat ligjore. Nuk ka kurrfarë korrupsioni dhe keqpërdorimi”.

Ai ka theksuar se ministrja Rozeta Hajdari ka bërë punë të mirë. Kurti e akuzoi Prokurorinë që nuk po merret me denoncimet e ministrave të tij për krimin e korrupsionin që ai thotë se e gjetën në institucione. “Me qindra raportime zyrtare e kallëzime penale i kanë deponuar ministrinë tona për krimin e korrupsionin që e

kemi gjetur, mirëpo përgjithësisht kjo nuk i ka bërë përshtypje Prokurorisë së Shtetit”, ka thënë Kurti.

Të dielën për ta mbrojtur Kurtin dhe këtë aferë korruptive kanë shkruar në rrjetet sociale edhe deputeti Armend Muja, zëvendësministri i Drejtësisë Blerim Sallahu dhe ministri i Financave, Herkurun Murati.

Deputeti Muja ka theksuar se sasia e munguar nuk është në vlerë 600 mijë euro, por 300 mijë. “Është dëmtuar buxheti për 601 000 euro - ose po mungon një shpjegim shtesë ose prokurori nuk e di matematikën elementare. Do të duhej të ishte 301 384 euro jo 601 000 euro. Dosja e prokurorit është e shkoqitur nga konteksti dhe ka gabime elementare. Me gjasë zyrtarët janë arrestuar pa u dëgjuar fare. Çka nëse vjen malli nesër, pas një jave apo muaji? Motivi për të stërpikur apo ‘luftuar puritanizmin e VV’ nuk është vetëm i opozitës. A dëgjojen eksponentët e PLAN që kanë shitur tokat bujqësore (2 euro ari), kanë vjedhur subvencionet e grurit dhe kanë shterur rezervat duke mbajtur ders?”, ka shkruar Muja.

Zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka theksuar se çështja me karakter komplet civil po tentohet të kthehet në çështje



Dosja e Prokurorisë: 52.5 tonë grurë, 200 mijë litra vaj dhe 120 mijë kg sheqer – në vlerë mbi 600 mijë euro, nuk erdhën në Kosovë

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka gjetur se përpos procedurës së kundërligjshme që është ndjekur në blerjet e rezervave shtetërore, ka edhe shkelje të tjera pasi malli i paguar s'ka mbërritur në Kosovë. Kështu, sipas dosjes së Prokurorisë, pavarësisht se janë paguar paratë te kompanitë turke e polake për grurë, vaj e sheqer, në Kosovë nuk kanë ardhur kurrë 200 mijë litra vaj, 120 mijë kg sheqer dhe 52.5 tonë grurë. Vlera e këtij malli që nuk ka

mbërritur në Kosovë, sipas Prokurorisë, është mbi 600 mijë euro. Në dosjen e Prokurorisë thuhet se biznesmeni Ridvan Muharremi ishte personi kyç që kishte zhvilluar negociatat me operatorët ekonomikë për blerjen e grurit, vajit e sheqerit. Ridvan Muharremi ngarkohet se në mënyrë të kundërligjshme kishte ndihmuar Irfan Lipovicën dhe Haviz Garën. U kishte krijuar kushte për negociimin me kompanitë turke e polake për blerjen

e grurit, vajit dhe sheqerit. Sipas Prokurorisë, Muharremi ishte personi kyç për t'i negociuar kushtet e kontratave me operatorët ekonomikë për blerjen e rezervave shtetërore. Gjithnjë sipas Prokurorisë, Muharremi kishte negociuar blerjen e 10 mijë tonëve grurë nga Turqia me çmim prej 4 milionë 834 mijë e 778 eurosh. Sipas Prokurorisë, Muharremi me këto kompani kishte pasur edhe më herët raporte kontraktuale dhe biznesore.

Muharremi ishte përfshirë në negociimin e blerjes edhe të vajit dhe sheqerit nga Polonia në vlerë prej 276 mijë eurosh, por që as vaji dhe as sheqeri nuk kanë mbërritur në Kosovë. Prokuroria e ngarkon Muharremin se ka kryer veprën penale "dhënie e ndihmës në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 lidhur me nenin 33 të Kodit Penal". Prokuroria në arsyetimin e nisjes

penale si formë hakmarrje ndaj qeverisë Kurti. Arrestimet e së premtes nxitën reagimin e opozitës e cila kërkoi përgjegjësi nga zyrtarët e lartë qeveritarë. Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se një kryeministër normal, kur përballet me situatë si ajo që ndodhi dy ditë më parë, kërkon nga drejtësia hetim të plotë e të shpejtë si dhe e vendos veten dhe vartësit e tij në dispozicion të drejtësisë. "Dyshimet rriten edhe për faktin se ky nuk i përgënjeshtrohet ato për të cilat ndodhën arrestimet, e ku përmendet edhe emri i tij, por i

shanë mediat, opozitën dhe organet e drejtësisë. Duket se kjo paska qenë arsyeja e insistimit të tij me çdo kusht, edhe pas opinionit të Komisionit të Venecias, që përmes ligjit ta kontrolloj Këshillin Prokurorial. Kjo paska qenë arsyeja pse ky nuk po i jep leje asaj ta dekretoj kryeprokurorin e ri. Kot e kanë", ka shkruar Hoti në "Facebook". Sekretari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Betim Gjoshi, ka publikuar tri deklarata: të kryeministrit Albin Kurti, të ministres Rozeta Hajdari dhe të avokatit të Ridvan Muharremit,

Mahmut Halimi, të cilat, sipas tij, e nxjerrin Kurtin përgjegjës kryesor të aferës korruptive të rezervës shtetërore. "Janë veç tri deklarata të dhëna brenda dy ditësh që e nxjerrin Albin Kurtin përgjegjës kryesor të aferës korruptive me rezervën shtetërore. Albin Kurti (18/08/2023): Nuk ka kurrfarë korrupsioni e keqpërdorimi. Unë kam besim të plotë në ministren Rozeta Hajdari dhe në punën e saj. Rozeta Hajdari (18/08/2023): Unë nuk kam asnjë informacion që personi në fjalë (Ridvan Muharremi) është në ndonjë kontratë ose kontraktim të

kontratave për rezervën shtetërore. Mahmut Halimi (19/08/2023 - avokat i Ridvan Muharremit): E ka angazhuar Ministria. Drejtpërdrejt ministria Hajdari. E ka lutur. E ka njohur si persona afarist, që ka traditë të gjatë, ka rreth të gjerë të miqve të vetë", ka shkruar Gjoshi në "Facebook". Edhe presidenti i AKR-së, deputeti Behgjet Pacolli, ka reaguar të dielën ndaj deklaratës së kryeministrit Albin Kurti, i cili ka drejtuar akuza në drejtim të gjyqtarëve dhe prokurorëve për korrupsionin në vend pas skandalit të rezervave

së hetimeve për keqpërdorime të rezervës shtetërore paralajmëron se në ditët në vazhdim do t'i identifikojë edhe personat e tjerë që do të ndiqen sipas detyrës zyrtare. "Është i pakontestueshëm fakti se e tërë procedura e blerjes së produkteve të rezervës shtetërore të Kosovës për vitin 2022 është zbatuar në kundërshtim me ligjin dhe procedurat", thuhet në kërkesën e Prokurorisë të cilën e ka siguruar "Betimi për Drejtësi".

Irfan Lipovica dyshohet se në cilësinë e zëvendëssekretarit në MINT ka tejkaluar autorizimet ligjore duke kërkuar nga qeveria anashkalimin e procedurave ligjore të prokurimit publik për blerjen e rezervave shtetërore. Prokuroria dyshon se Lipovica e bëri këtë kërkesë për ta kufizuar konkurrencën dhe fshehur shkeljen e ligjit. Sipas Prokurorisë, vendimi i qeverisë i 22 shkurtit 2022 ishte marrë duke pasur për bazë kërkesën e kundërligjshme të Lipovicës për anashkalimin e procedurave ligjore për blerjen e rezervave. Lipovica ngarkohet se në mënyrë të kundërligjshme ka formuar edhe një Komision për Negocimin e Kontratave për Furnizim të Mallrave të Rezervës Shtetërore për vitin 2022 me të cilin ka anashkaluar procedurën e hapur të prokurimit publik. Megjithëse komisioni ishte formuar kundërligjshëm, Prokuroria e ngarkon Lipovicën se kishte anashkaluar dy anëtarët e Komisionit dhe e kishte përfshirë Ridvan Muharremin në rolin e ndërmjetësuesit në mes të Ministrisë dhe Operatorëve Ekonomikë nga Turqia për blerjen e grurit.

Sipas Prokurorisë, pavarësisht se pagesat ishin bërë 100 për qind me operatorët ekonomikë nga Turqia e Polonia, raporton "Betimi për Drejtësi". Porosia prej 200 mijë litrash vaj dhe 120 mijë kg sheqer nuk kanë ardhur fare pavarësisht se pagesat ishin bërë avans. Ndërsa për gjithë grurin e kontraktuar ishin paguar 4 milionë e 834 mijë e 778 euro derisa në Kosovë nuk kanë mbërritur 52.5 tonë grurë. "Pavarësisht se pagesa në formë të avansit është realizuar në tërësi, në Kosovë, si vend i destinimit, janë sjell vetëm 9.947.5 tonë grurë ose 52.5 tonë më pak se sasia e kontraktuar. Ndërsa lloji vaji dhe sheqer nuk janë sjell fare. Si rezultat i këtyre veprimeve është dëmtuar interesi publik në lartësi prej 601 mijë e 940 eurosh", ka konstatuar Prokuroria.

shtetërore. Pacolli ka thënë se në botën civilizuese, sidomos në shtetet më të zhvilluara dhe me demokraci të konsoliduar, asnjëherë nuk ka dëgjuar që udhëheqësit e shtetit t'i ofendojnë gjyqtarët dhe prokurorët e tyre. "Nuk kam dyshime për aftësitë e kryeministrit tonë në udhëheqjen me popullin e Kosovës, por jam shumë kurioz për të kuptuar se çfarë kontribuon në qeverisjen me duar të pastërta", kur njerëzit që ndihmojnë në këtë proces (prokurorët dhe gjyqtarët), nga vet drejtuesit e shtetit sulmohen", ka shkruar Pacolli në "Facebook".

Rritet për 10 për qind numri i të prekurve me kancer të gjirit brenda 7 muajve në Kosovë

PRISHTINË, 29 GUSHT - Numri i të prekurve me kancer të gjirit në Kosovë është rritur për më shumë se 10 për qind në shtatëmuajorin e vitit 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Deri në gjysmën e gushtit të këtij viti 270 persona janë diagnostifikuar me këtë sëmundje malinje, ku katër prej tyre janë meshkuj. Nga Klinika e Onkologjisë thonë se ka nevojë për rritje të stafit mjekësor, ndërsa shprehen se u mungon një

hapësirë më e madhe për t'i trajtuar pacientët. Sa i përket furnizimit me barna esenciale, nga kjo klinikë thonë se qëndrojnë mirë. Drejtori i Klinikës së Onkologjisë, Ilir Kurtishi, thotë se numri i të prekurve me kancer të gjirit po rritet nga viti në vit, ndërsa shton se ky numër mund të kalojë mbi 450 deri në fund të vitit. "Numri është duke u rritur nga viti në vit. Kemi diku 10-15 për qind raste më shumë nga viti në vit dhe për

shtatëmuajorin e parë të këtij viti 2023, ne kemi identifikuar rreth 1 230 raste me kancer në total të të gjitha rasteve. Për shtatëmuajorin e parë kemi 270 raste me kancer të gjirit, që për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është 10 për qind pak më shumë se vitin e kaluar. Mendojmë se ky numër mos të kalojë shifrën prej 450 rasteve të reja me kancer të gjirit deri në fund të vitit", tha Kurtishi për "KosovaPress".



Fshati Studime e Poshtme harrohet nga pushteti lokal, vizitohet vetëm kur ka fushatë zgjedhore

VUSHTRRI, 20 GUSHT - "Fshati Studime e Poshtme që përjetoi tri masakra me afër 140 viktima në luftën e fundit sot është i harruar nga pushteti lokal. Vitet e luftës ishin sfiduese për mbarë Kosovën, por fshati Studime e Poshtme përjetoi një golgotë dhe tmerr të paparë", kështu ka shkruar në "Facebook" ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu.

Ai thotë se përveç maltretimeve të shumta, më 2 maj 1999 ndodhi një ndër masakrat më të mëdha në Kosovë, ku u ekzekutuan në mënyrë barbare 124 viktima nga barbarët serbë. "Tragjedia e tillë u përsërit më 9 maj 1999 ku u pushkatuan dhe u masakruan 8 gra dhe vajza që ishin duke dërguar ushqim dhe ndihma në shtabin e UÇK-së. Dhe kjo nuk i ngopi armiqtë serbë dhe me datën 31 maj po të atij viti, u ekzekutua familja Gërxhaliu me 13 anëtarë nga të cilët 8 fëmijë, 3 gra dhe 2 burra. Përkundër traumave të luftës, shpresuam se nga pushteti kjo familje dhe ky fshat do të kenë një trajtim dhe një mbështetje të veçantë siç po e kanë disa fshatra të tjera, por ndodhi e kundërta", thotë Gërxhaliu. Ai shton se tragjedia më e madhe është fakti që u politizua çdo pore e shoqërisë pas luftës dhe u ndëshkuan të gjithë ata që nuk janë të mendimit të njëjtë. "Dhe fshati Studime në njëfarë forme u



penalizua gjithmonë nga pushteti lokal i kohës. Derisa në fshatrat e tjera investonin në mënyrë të pakontrolluar dhe për të përfituar nga tenderët e kohës, ku ka fshatra të 'përkatesisë politike' të cilat kanë pasur prioritet në investime dhe në të cilat është investuar në të kaluarën dhe investohet edhe tash në mënyrë permanente, ndërsa fshati Studime e Poshtme u anashkalua dhe penalizua nga pushteti me qëllim apo pa

qëllim që bëri, që edhe jetesa në fshatin Studime është dënim dhe mjerim në të njëjtën kohë", ka treguar Gërxhaliu, duke shtuar se sa është anashkaluar fshati Studime nga pushteti lokal dhe sa nuk është investuar dëshmon fakti që edhe sot nuk ka kanalizim. "Edhe sot kemi rrjet të dobët të energjisë elektrike, rruga e cila është dëmtuar ka qenë bashkëfinansim nga banorët. Shkolla ekziston që

nga vitet '80, pa çerdhe të fëmijëve, pa shtëpi të shëndetit dhe në veçanti është mungesa e murit mbrojtës të lumit të fshatit, i cili në mënyrë permanente paraqet rrezik për fshatarët dhe shumë projekte të tjera", ka thënë ai. Gërxhaliu shton se për ta kuptuar këtë mjerim të fshatit Studime, falë pakënaqësisë së banorëve, 60 % kanë migruar dhe projektionet janë që ky trend të vazhdojë. "Shqetëson fakti që ky fshat vizitohet vetëm

kur ka fushata zgjedhore në nivel lokal apo qendror ku premtimet janë të shumta, mirëpo në realitet pas zgjedhjeve rritet vetëm pakënaqësia e banorëve dhe jo e investimeve. Por për ta kuptuar të vërtetën e mjerueshme të fshatit Studime mos u besoni fjalëve të mia, por besoni fotografive të bashkangjitura më poshtë dhe të bindeni se 1 fotografi flet më shumë se 1 000 fjalë", ka shkruar Gërxhaliu në "Facebook".

Nis ndërtimi i një rruge në Mitrovicë, Krasniqi: Edhe në mungesë të mbështetjes së qeverisë ne s'do të ndalemi

MITROVICË, 20 GUSHT - Ka filluar hapja dhe ndërtimi i rrugës "Ali Zeneli" në Mitrovicë, nga e cila do të përfitojnë rreth 700 familje, të cilave do t'u bëhet qarkullimi edhe jetesa më e lehtë. Realizimin e këtij projekti e ka mirëpritur kryetari i PDK-së, partisë që udhëheq këtë komunë, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se, edhe pse "në

mungesë të mbështetjes nga qeveria qendrore, nuk do të ndalemi asnjë ditë". "Jam i lumtur dhe krenar me Bedriun dhe ekipin e tij, nën udhëheqjen e të cilit Mitrovica çdo ditë po merr pamje tjetër. Një qytet i organizuar, ku zyrtarët komunalë japin llogari dhe ku institucionet angazhohen çdo ditë për mirëqenien e

qytetarëve të tyre, është gjithçka që kanë merituar mitrovicasit", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Kryetari i komunës, Bedri Hamza, ka bërë me dije se kjo rrugë si një nga premtimet kryesore në fushatën e tij zgjedhore, pritet të hapet nga rrethi kryesor duke vazhduar deri tek Universiteti i Mitrovicës.



Mbyllet një muaj para kohe afati për aplikim për subvencionimin e izolimit të shtëpive

PRISHTINË, 20 GUSHT - Afati për aplikim për subvencionimin e izolimit të kushtueshëm të shtëpive është mbyllur pak më shumë se një muaj para kohe për shkak të mijërave aplikimeve, tha të dielën Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE). “Nga sot aplikimi në platformën e-Kosova është mbyllur, ndërsa FKEE është në proces të shqyrtimit të aplikimeve të pranuar”, njoftoi Fondi më 25 gusht në një postim në “Facebook”.

Më 8 gusht Qeveria e Kosovës e hapi thirrjen publike për aplikim për masa të eficientës së energjisë për shtëpitë individuale të banimit.

Afati për aplikimin u caktua të ishte i hapur deri më 25 shtator 2023. Por, Fondi tha se gjatë 13 ditëve i ka pranuar “mbi 2 000 aplikime të cilat përmbushin buxhetin e paraparë për projektin ‘Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë për

Shtëpitë Individuale të Banimit”. Qeveria do t’i subvencionojë rreth 2 000 familje deri në 50 për qind të koston së investimit, e kufizuar në shumën prej 5 500 eurosh.

Ky subvencion përfshin koston e izolimit të jashtëm të shtëpisë, ndërrimin e dritareve dhe të derës së hyrjes si dhe izolimin e kulmit.

Për këtë projekt janë ndarë gjithsej 10 milionë euro.

Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit IPA [Instrumenti i Para-anëtarësimit] - Pako për Mbështetjen e Energjisë, i aranzhuar nga Qeveria e Kosovës dhe i zbatuar nga FKEE.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se indeksi i tërësishëm i koston së ndërtimit ka pësuar rritje për 3.3 për qind në tremujorin e parë të vitit 2023 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2022.



Vagonët e ndryshkur shndërrohen në kënd lojërash



PRISHTINË, 20 GUSHT - Hapësira dhe objekte të braktisura që nga përfundimi i luftës në vitin 1999 në Kosovë janë bërë qendra kërkimi e disa të rinjve për ta shprehur kreativitetin e tyre, por edhe për t’i kthyer ato në shërbim të komunitetit.

Në qytetin e Fushë-Kosovës, në afërsi të Prishtinës, është një nga qendrat e kërkimeve të organizatës së të rinjve “Name Comes Last”.

Në afërsi të hekurudhës, në një lagje të banuar kryesisht nga komuniteti rom, një hapësirë e mbushur me mbeturina të ngurta dhe disa vagonë treni të viteve ’70 nisi të transformohej në diçka që do të vihej në shërbim të banorëve të lagjes.

Në verën e vitit të kaluar kjo hapësirë u shndërrua në një kënd lojërash për fëmijët e komunitetit rom. “Fushë-Kosova

u bë qendra e hulumtimit dhe e motivit të punës sonë, duke synuar angazhimin afatgjatë të rinisë nga lagjet, në skenën artistike dhe kulturore të Prishtinës”, thotë për “Radion Evropa e Lirë”, Blerim Avdili nga organizata “Name Comes Last”. Sipas tij, në këtë lagje në Fushë-Kosovë mungon infrastruktura themelore publike, sikurse uji i pastër për pije, sistemi i kanalizimit, transporti publik, ndriçimi publik dhe trotuaret. “Kombinuar me hekurudhat dhe diskriminimin nga komunitetet e tjera, kjo situatë e ka izoluar edhe më shumë zonën”, thotë Avdili. Ai shton se në lagjen e banuar me pjesëtarë të komunitetit rom nuk kishte ndonjë hapësirë të sigurt për fëmijët dhe adoleshentët.

Avdili tha se zona ku është vendosur këndi i lojërave për

dekada ishte përdorur si vend për hedhjen e paligjshme të mbeturinave, duke bërë që ambienti të kontaminohej. Kjo situatë, thotë Avdili, bëri që fëmijët të ambientoheshin dhe të jetonin në këto kushte të pafavorshme.

Në vagonët e ndryshkur u vendosën dysheme, u ndërtuan shkallë dhe dyer nga materiale të ricikluar.

Disa nga materialet e përdorura për rregullimin e këndit të lojërave janë marrë edhe nga fabrikat dhe hapësirat e tjera të braktisura.

Për rregullimin e këndit të lojërave ndihmuan edhe fëmijët dhe banorët e tjerë të lagjes, thotë Avdili. “Hapi i parë ishte një projekt bashkëpunues, për t’u njohur me njëri-tjetrin. Qëllimi ynë afatgjatë është krijimi i një qendre kulturore, të lidhur me

skenën alternative në Prishtinë, duke organizuar shkëmbime artistike dhe kulturore dy herë në vit”, thekson ai.

Druri i ricikluar u përdor më shumë në vagonët e trenit. Aty u ndërtuan ulëse, të cilat mund të përdoren nga fëmijët dhe prindërit e tyre për ta kaluarën kohën e lirë.

Një nga materialet e tjera më të përdorura në këndin e lojërave janë gommat e makinave të cilat u mblodhën nëpër qytetin e Fushë-Kosovës.

Gomat më pas u ngjyrosën me ngjyra të ndryshme dhe u përdorën si elemente zbukuruese në këndin e lojërave. Në këtë kënd lojërash janë ndërtuar kolovajza e ulëse që fëmijët, por edhe prindërit e tyre të kalojnë momente argëtuese.

Ky kënd lojërash mund të përdoret nga fëmijët pavarësisht

prej kushteve atmosferike dhe është i vetmi vend që fëmijët e lagjes kanë për t’u argëtuar.

Kosova ka shumë hapësira e ndërtesa të braktisura. Po ashtu, në lagjet ku kryesisht jetojnë pjesëtarët e komunitetit rom ka mungesë të këndeve të lojërave për fëmijët.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, në Kosovë jetojnë 8 824 romë.

Komuniteti rom në Kosovë përballet me nivel të lartë të papunësisë dhe arritje të ulët arsimore. Pjesëtarë të këtij komuniteti jetojnë kryesisht në vendbanime me infrastrukturë të dobët dhe në shtëpi që kanë kushte minimale banimi.


Organizata e të rinjve “Name Comes Last” në shtator të këtij viti do të kthehet edhe një herë te këndi i lojërave në Fushë-Kosovë për ta vazhduar ndërtimin, por edhe organizimin e ngjarjeve dhe punëtorive. “Ne punojmë vazhdimisht për të siguruar më shumë fonde, kështu që mund të vazhdojmë të ndërtojmë në lagje, qofshin këto lojëra ose projekte të tjera”, thotë Avdili nga organizata “Name Comes Last”.

Në Raportin e Progresit për Kosovën, të publikuar nga Komisioni Evropian në vitin 2021, situata e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në vend është cilësuar “e vështirë”.

Shqetësimet për këto komunitete janë shprehur edhe nga organizata për të drejtat e njeriut, Human Rights Watch, me seli në Shtetet e Bashkuara.

Në raportin e publikuar në janar, Human Rights Watch tha se “diskriminimi ndaj romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Kosovë mbetet problem”.

Një biografi e shkurtër e Djallit



Nga Jonny TOMSON

Nuk mund të tregohet historia e mendimit perëndimor, pa rrëfyer gjithashtu edhe historinë e Krishterimit. Kultura, vlerat dhe institucionet politike të Evropës, u farkëtuan të gjitha nën syrin vigjilent të Kishës. Dhe sipas teologut Filip Almond “Historia e Krishterimit, nuk mund të tregohet pa Djallin”.

Nga kjo rezulton se nuk mund të tregosh historinë e mendimit perëndimor, pa folur për Djallin. Pavarësisht nëse e quani Luçifer, Satana, Belzebub, Princi i Errësirës apo Zoti i Mizave, Djalli është një figurë qendrore në historinë intelektuale të Perëndimit. Ai shfaqet në letërsinë klasike dhe kulturën popullore, ndërsa në emrin e tij ka shumë këngë. Por Djalli ka një biografi të ndërlikuar dhe plot zig-zage.

Beteja midis së mirës dhe së keqes

Nëse lexoni Testamentin e Vjetër, duke kërkuar për betejat midis ushtrisë demoniake të Satanit dhe kryeengjësve të Zotit, do të zhgënjeheni. Çuditërisht, Djalli mungon tërësisht Biblën Hebraike. Edhe aty ku shfaqet, Satani është pak a shumë nën komandën e

Zotit.

Për shembull, në Librin e Jobit, Satani është një tundues, por nën udhëzimet specifike të Perëndisë. Në hebraisht fjala ‘Satan’, nuk është emri i duhur që përshkruan një person me brirë në kokë dhe që është mishërimi i të keqes. Përkundrazi, fjala hebraike për Satanin (שטן) do të thotë kundërshtar.

Ai ishte një lloj titulli. Në Dhiatën e Vjetër nuk ka avokatë të djallit, sepse të gjithë avokatët ishin djaj. E gjitha kjo ndryshon në një koleksion të njohur si Libri i Vëzhguesve. Këtu, tradita hebraike rivalizon Xhon Miltonin dhe Hollivudin për spektaklin qiellor.

Sipas këtij rrëfimi, një grup engjëjsh të njohur si “vrojtuesit” rebelohen kundër Perëndisë dhe zbresin në tokë për të luftuar, ushqyer dhe shthurur moralisht. Mbrojtësi kryesor, një engjëll i quajtur Azael, u mëson njerëzve prodhimin e armëve dhe bizhuterive (të cilat nuk janë ndoshta probleme ekuivalente).

Më pas ai u përfshi në festa të harbuara demoniake, ndërsa njerëzimi e shpërbëri veten e vet në aspektin moral. Më në fund, Zoti vendos të ndërhyjë dhe dërgon armët e tij të mëdha: kryeengjëjt. Së pari, Sarieli e paralajmëron Noenë për një përmbytje të madhe që do të fshijë çdo gjë në Tokë.

Pastaj, Rafaeli rreh dhe e burgos Azaelin. Në fund, Mikaeli dhe Gabriel – udhëheqës të ushtrisë qiellore – mundin vetë rojet (dhe fëmijët e tyre gjigantë dhe monstruozë) dhe i detyrojnë ata të jetojnë përgjithmonë nën Tokë. Është hera e parë në mendimin judeo-kristian që kemi idenë e demonëve që jetojnë në një mjedis që i ngjan shumë Ferrit.

Dhiata e Re, Satanai i Ri

Tek Ungjijtë, Luçiferi promovohet nga personazhi dytësor në personazhin kryesor. Për 40 ditë dhe net, Jezusi nis një agjërime ritual, në fund të të cilit i shfaqet Satani. Në një imazh pasqyrë të rënies së Adamit dhe Evës, Jezusi u reziston të gjitha tundimeve të Djallit, dhe e lë duelin e tij në shkretëtirë me arritjen e fitores.

Në Testamentin e Ri, Djallit i jepet gjithnjë e më shumë përgjegjësi mbi gjërat e liga të botës. Për disa teologë, Djalli bëhet i keq. Aty vendoset një narrativë ku gjithçka ishte mirë për botën, por më pas Djalli solli të keqen në planetin tonë, dhe e mbolli atë në zemrat e njerëzve. Gjithçka është një fushëbetejë midis forcave të së mirës dhe së keqes, Zotit dhe Djallit.

Megjithatë, cilido që dëshiron të kuptojë teologjinë e krishterë, duhet të ecë me

kujdes. Krishterimi nuk është një fe dualiste. Ai nuk e ndan botën në të kundërta polare, pra në të mirën dhe të keqen, shpirtin dhe trupin, Parajsën dhe Ferrin.

Në fakt, Etërit e hershëm të Kishës ishin shumë të etur ta shmangnin këtë mesazh. Kjo sepse ndërsa krishterimi po konkurronte për të konvertuarit dhe një fe rivale, manikeanizmi, kishte të bënte me dualizmin. Si historian fetar, Xhefri Rasëll tha se “shumica e të gjithë mendimtarëve të krishterë besonin se Djalli nuk është një parim i pavarur, por një engjëll i rënë që e përdori vullnetin e tij të lirë për të refuzuar Perëndinë”.

Njerëzve si Agustini dhe Ireneu u takoi puna e vështirë e rrëfimit për njerëzit të një historie mbi të mirën dhe të keqen, por pa e reduktuar gjithçka në bardhë e zi. Kjo donte të thoshte se Luçiferi duhej të ishte paksa në orbitën e Zotit dhe pjesë e planit hyjnor.

Njeri me pasuri dhe shije

Por problemi është se hollësitrat teologjike nuk marke-tohen dhe aq mirë. Botuesit e librave dhe regjizorët e Hollivudit, nuk kanë qenë kurrë kaq të shqetësuar për bërjen e një dallimi kuptimplotë midis dogmës së krishterë ortodokse dhe rivalëve gnostikë. Kësisoj

shohim betejat me shpata që flakërojnë dhe përbindështa që ulërijnë.

Shohim krijesa me krahë dhe me bishta me luspa, me aureola verbuese dhe me brirë dhish. Me pak fjalë kemi një dualizëm. Përgjatë historisë, Satani përfaqëson gjithçka që është e gabuar me botën. Djalli është i keq.


Kjo është arsyeja pse Satani përshkruhet kaq shpesh në ikonografinë pagane: Ai përshkruhet pothuajse gjithmonë si një Perëndi e feve rivale. Është një nga bazat e propagandës ta portretizosh armikun tënd si mishërim të vetë të keqes. As sot nuk është ndryshe.

Kur Ruhollah Khomeini i Iranit e quajti Amerikën “Satani i madh, gjarpri i plagosur”, ai po thoshte se sa shumë e urrente këtë vend. Në kulturën popullore, Satani përfaqëson veset e kohës sonë: dhunën, epshin dhe lakminë. Luçiferi është njeriu me makinën e shpejtë dhe me një rezidencë të madhe.

Në thelbin e saj, historia e Satanit është një pasqyrim i luftës që kryen vetë njerëzimi ndaj koncepteve të së mirës dhe së keqes. Është një projekcion i frikës sonë më të errët dhe i pyetjeve më të thella. Ndërsa imazhi dhe roli i Satanit kanë evoluuar me kalimin e kohës, prania e tij gjithmonë do të na përndjekë nga qoshet e moralit tonë. / “Big Think” – Bota.al

Kundera, legjenda që u bë fantazmë

Jeta është diku tjetër, na mësoi: në gjërat e vogla. Në magjepsjen e përditshmërisë. Dhe në liri



Duhet një talent i madh edhe për t'u zhdukur. Në stinën e gjatë të qenies, zoti Milan Kundera (1929-2023) kishte zgjedhur të mos ishte. Ose jo deri në fund, jo plotësisht. Një emër i koduar në një citofon. Asnjë intervistë. Asnjë deklaratë. Asnjë shfaqje. Duket se për të marrë përgjigjen me telefon, telefonin e vjetër fiks, duhej zile me kod: fillimisht një, pastaj dy. Pastaj kapte telefonin. Por jeta është diku tjetër, siç na mësonte ai; është edhe diku tjetër – dhe atëherë ndoshta mjaftonte të prisje që ai të telefononte. Kundera, me kohë, kishte zgjedhur të ekzistonte vetëm përmes fjalëve të shkruara. Si ato të romanit të fundit, “Festa e parëndësisë”, botuar dhjetë vjet më parë. Faqet e tij – shumë të lehta, padurueshmërisht të lehta – shfaqnin një shkëputje kurioze nga jeta, një urtësi ironike e një filozofi të lashtë. Një roman-traktat i pazakontë: ngatërrimi i rrëfimit me

meditimin, ndalesat reflektuese. Personazhet – ai i quante heronj – vazhdimisht dialogojnë, përballen me njëri-tjetrin, përplasen. Për çfarë? Për jetën, për gjërat e vogla të jetës. Është një burrë që reflekton mbi kërthizat e zhveshura të vajzave. Është një mik i tij që mendon për pikturat e Chagall. Është një burrë tjetër që zbulon se nuk ka kancer. Një tjetër që është joshës serial tashmë në moshë të thyer. Ata e shikojnë botën, e përshkojnë, mendojnë për të, me një shpërqendrim qesharak, sikur asgjë nuk mund të merret seriozisht deri në fund: «Në jetë njerëzit takohen, bisedojnë, diskutojnë, debatojnë, pa e kuptuar se i drejtohen njëri-tjetrit nga nga larg, secili nga një observator i vendosur në një vend të ndryshëm në kohë». Plaku Kundera i përshkruante personazhet e tij me një atmosferë argëtuese, si aktorë në një komedi, si kukulla. Asgjë nuk ndodh: është vetëm jeta që

kalon, jeta e përditshme, mendimet e mira apo mizore që na përshkojnë. Ne jemi një turmë njerëzish anonimë të ndarë mes “kërkesëfaljeve”, atyre që jetojnë të dërrmuar nga ndjenja e fajit dhe atyre që sulmojnë dhe arrijnë t'i bëjnë të tjerët të ndihen fajtorë. E pastaj? Çfarë ka vërtet rëndësi? Kërkimi, më shumë se sa i lumturisë, i një “humori të mirë e të përjetshëm” hegelian: e vetmja gjendje shpirtërore që ka kuptim të arrihet, përballë parëndësisë së gjithçkaje. Kundera nihilist? Aspak. “Parëndësia, miku im, është thelbi i jetës. Ajo është me ne kudo dhe gjithmonë. Është gjithashtu e pranishme aty ku askush nuk dëshiron ta shohë: në tmerre, në beteja të përgjakshme, në fatkeqësitë më të mëdha. Shpesh duhet guxim ta njohësh në kushte kaq dramatike dhe ta quash me emrin e vet”. Dhe mbi të gjitha, thoshte Kundera, duhet ta

duash atë.

Ndoshta kjo është arsyeja pse ai shkroi atë apologji korale ndriçuese, në qendër të së cilës është historia befasuese e një funksionari stalinist që vuante nga prostata. Përballë këtij të gjori, mizoria e Stalinit bën një hap prapa deri në pikën që ai i jep një qyteti rus, emrin e “të padobishmit” zotit Kalinin. Parëndësia nuk e vret butësinë, përkundrazi. A nuk është kjo një arritje e madhe? Për një intelektual çek të përjashtuar nga partia komuniste dhe të strehuar në Francë, duhet të ketë qenë në fakt heroike: një shenjë e një lirie mendore të padiskutueshme. Aftësia për të qëndruar pezull mbi detin e plumbit të ideologjisë për të mbrojtur ndjenjën e jetës minimale, konkrete – e përbërë nga trupa që prekin njëri-tjetrin, takohen, puthin, bëjnë dashuri. Ata kujtojnë dhe flasin, flasin e flasin. Ndonjëherë harrojnë. Ata

harrojnë. Pastaj ndoshta mblidhen së bashku, dhe është e vështirë. Por disi edhe bukur: për sa kohë që shqisat janë vigjilente. Ndonjëherë ndizen. Duhet guxim për të mos humbur një magjepsje sensuale në jetën që e quajmë përditshmëri. Dhe mbase ajo lehtësi e padurueshme e qenies, e cila është shndërruar brutalisht në një proverb, është më pak e arritshme, sesa na dukej në vitet e shkujdesura kur u publikua romani. Kundera i vërtit të gjitha fjalitë rreth detyrave të vogla të padurueshme, impotencës (fizike, seksuale, mendore), bllokimeve të frikës dhe anktheve që nuk mund t'i kapërcejmë. Supozon dhe na bën të supozojmë se dashuria – dashuria për jetën – mund, duhet të jetë “diçka e lehtë, diçka që nuk ka peshë”. / L'Espresso – Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Malisheva e Ballkani dominojnë Superligën



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 21 GUSHT - Kampionia në fuqi e Kosovës, Ballkani shkëlqimin e ka vazhदार edhe në rrafshin vendor pra në Albi Mall Superligë, kësaj radhe duke fituar në shtëpi kundër Feronikelit 74, me rezultat 2-0. Në minutën e dytë shtesë të pjesës së parë, Albin Berisha shënoi me kokë nga afërsia. Fitorja e portokallezinjve u konfirmua në minutën e 69-të, kur Robert Rrahmani shënoi autogol pas harkimit të Almir Ajzerajt. Fitoren e parë e ka regjistruar Llapi, teksa e ka mposhtur me rezultat bindës Dukagjinin në stadiumin “Zahir Pajaziti”, me rezultat 3-0. Golat

për skuadrën e drejtuar nga Tahir Batatina i shënuan Ilir Blakçori (69’), Muhamet Hyseni (78’) dhe Trimor Selimi (88’). Për Dukagjinin kjo ishte humbja e dytë. Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje të javës së dytë në Albi Mall Superligë. Liria ka arkëtuar pikën e parë pas rikthimit në elitë, pasi në shtëpi ka barazuar me Dritën, pa gola 0-0. Ishin gjilanasit e dominuan ndeshjen dhe shënuan tre gola, por asnjëri prej tyre nuk ishte i vlefshëm për shkak të pozitës jashtëloje. Ndërkohë, Malisheva ka regjistruar fitoren e dytë në këtë edicioni të ri, kësaj radhe duke e mundur Fushë Kosovën, me rezultat 6-1. Ndeshja që e përmbyll javën e dytë është paraparë të zhvillohet sot (e

hënë) ndërmjet Gjilanit dhe Prishtinës.

SUPERLIGA	
Ballkani - Feronikeli 74	2-0
Llapi - Dukagjini	3-0
Liria - Drita	0-0
Malisheva - Fushë Kosovë	6-1
Të hënën takohen:	
Gjilani - Prishtina	
Tabela	
1. Malisheva	6 pikë
2. Ballkani	6
3. Drita	4
4. Prishtina	3
5. Llapi	3
6. Liria	1
7. Gjilani	0
8. Feronikeli 74	0
9. Dukagjini	0
10. Fushë Kosova	0

SHKURT

Spanja, kampione e botës

Spanja ka arritur të shpallet kampione e botës në futboll në konkurrencën e femrave. Vashat spanjolle triumfuan në finalen e madhe ndaj Anglisë me rezultat minimal 1-0. Ishte kapitenia Olga Carmona që realizoi golin më të rëndësishëm në karrierë në minutën e 29-të të ndeshjes. Gol ky që në fund do ta shpallte kampione Spanjën. Madje, ato patën mundësi të artë të dyfishonin epërsinë, por Hermoso dështoi të realizonte nga penalltia. Kësisoj, Anglia duhet të kënaqet me pozitën e dytë në botë, pas një kampanje fantastike.

Messi fiton Ligën e Kupës në Amerikë

Lionel Messi fitoi trofeun e parë në tokën amerikane teksa ylli argjentinas ishte protagonist në finalen e Ligës së Kupës për Inter Miamin ndaj Nashville, të fituar me penallti pasi koha e rregullt përfundoi në barazim 1-1. Ishte pikërisht Kampioni i Botës ai i cili zhbllkoi shifrat në pjesën e parë teksa realizoi një super gol në minutën e 23-të. 36-vjeçari shënoi me të majtën në hyrje të zonës kundërshtarë dhe e dërgoi topin në trekëndësh për të mos i lënë asnjë mundësi reagimit portierit kundërshtar.

Barcelona merr fitoren e parë në La Liga

Barcelona ka arritur një fitore të vuajtur 2-0 ndaj Cadizit, edhe pse shifrat në tabelë nuk tregojnë një gjë të tillë. Cadizi i hapi jo pak probleme skuadrës katalanase gjatë pjesës më të madhe të lojës, por në minutën e 82-të del në skenë Pedri, që pas një asistimi perfekt të Gundoganit, arrin të mposhtë portierin Ledesma. Barcelona gjeti golin e sigurisë në minutën e dytë shtesë me Ferran Torresin, që gjeti hapësira boshë në qendër të mbrojtjes pas pasimit nga Lewandowski.

West Ham mposhti Chelsean

West Ham ka arritur një fitore spektakolare 3-1 në derbin e Londrës kundër Chelsea-t. Ndeshja nisi mjaft mirë për vendasit që shënuan me Aguerd, i cili me një goditje me kokë e dërgoi topin në rrjetë. Chelsea u kundërpërgjigj me Chukwuemeka dhe mori barazimin në minutën e 28-të. Ndërkohë në minutën e 43’ “blutë” patën mundësinë që të kalonin në avantazh, por Enzo Fernandez nuk ia doli të shënonte nga pika e bardhë e penalltisë. Në fillimin e pjesës së dytë, “The Hammers” u rikthyen në avantazh falë një goli të shënuar nga Anonio. Aguerd la ekipin e West Ham me një lojtar më pak, por që nuk do të shfrytëzohej nga Chelsea. Në kohën shtesë madje, Pauqeta do të shënonte golin e tretë me penallti. Pas javës së dytë të Premier League, West Ham shkon në kuotën e katër pikëve në vend të gjashtë, teksa Chelsea me një pikë renditet në vend të 14-të.

Besim Brahimi jep dorëheqje nga posti i trajnerit në Kosovës në boks

Prishtinë, 20 gusht - Trajneri i Kosovës në boks, Besim Brahimi ka bërë të ditur se ka dhënë dorëheqje nga ky post. Ai njoftimin e ka dhënë përmes një postimi në “Facebook” ku edhe ka zbuluar arsyet prapa këtij vendimi të tij. Ai ndër arsyet vendimtare ka përmendur mospagesën për kontributin e tij, si dhe disa mosmarrëveshje me Bordin e Federatës së Boksit. “Më datën 19 gusht 2023, për

arsye personale dhe ndërhyrje profesionale në selektimin dhe përpilimin e listës së boksierëve, të nderuar adhures të boksit më duhet t’ju njoftojë se sot kam dhënë dorëheqje të përvokueshme nga pozita e selektorit të Përfaqësuesit të Kosovës në Boks, edhe disa arsye tjera: 1. Për mospagesën për kontributin tim si selektor, duke u angazhuar gjithmonë në baza vullnetare, 2. Për

mosmarrëveshje me bordit dhe ndikimin e tyre direkt në punën time si selektor. Andaj të dashur boksierë dua t’ju kërkojë ndjesë për dorëheqjen time dhe dua t’iu falënderojë të gjithë boksierët për kontributin dhe angazhimin profesional duke ju uruar së pari shëndet dhe shumë suksese në të ardhmen unë ju falënderojë shumë të gjithë pa dallim”, ka shkruar Brahimi.





Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Drejtor i operativës – 1 pozitë

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek: Kryeshafi Ekzekutiv

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Organizon, koordinon dhe harmonizon punën e gjithëmbarshme në njësinë e operativës dhe punëtorinë e mirëmbajtjes në nivel regional;
- Kujdeset për sigurimin e kushteve për punëtorët në kryerjen e punëve dhe detyrave dhe për angazhimin e plotë të punëtorëve në funksion të ofrimit në kontinuitet të shërbimeve;
- Përcjell zbatimin e orarit të kryerjes së punëve në njësinë;
- Jep propozime dhe instruksione për aplikimin e standardeve të përparuar rreth higjienës publike dhe kujdeset për aplikimin e tyre në praktikë;
- Përcjell zgjerimin e qytetit – zonës së shërbimit dhe periferisë dhe harmonizon planet e shërbimit;
- Në bashkëpunim me menaxherët e operativës përpilon orarin e kryerjes së shërbimeve dhe bën publikimin e tij;
- Pranon raportet e punës nga Menaxherët dhe bën vlerësimin dhe verifikimin e tyre;
- Kontrollon urdhëresat e punës, përcjell dhe analizon evidencat nga deponia e mbeturinave;
- Kërkon blerjen e pjesëve dhe pajimeve për automjetet, lejon kërkesat e pjesëve rezervë nga depo;
- Përcjell shfrytëzimin racional të kapacitetit teknik;
- Koordinon punët dhe veprimet e ndërlidhura ndërmjet shërbimit të operativës dhe shërbimit financiar me klient, për ngritjen e kualitetit të Shërbimeve;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Kryeshafit ekzekutiv;

Shkathësitë e kërkuesit: (aftësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga juridik dhe administratës publike; Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Shkathësi për shqyrtimin e lëndëve apo shkresave të ndryshme të punës së përditshme të ndërmarrjeve;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë Universitare;
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale;

Konkursi është publikuar më datë 21 gusht 2023 dhe mbyllet më datë 04 shtator 2023.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
- Dy rekomandime (*nëse keni*);
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (*nëse ekzistojnë të tilla*);
- Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Certifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSIVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit. Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Na osnovu člana 8. Zakona br. 03/L-212 o radu, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" S.A. u Prištini, objavljuje:

KONKURS

Naziv pozicije: Direktor operacija – 1 radno mesto

Institucija: Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" Sh.A – Priština

Zvanje supervizora:/Izveštava: Glavni izvršni direktor

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Sa neodređenim rokom

Dužnosti i odgovornosti: (kratak opis glavnih zadataka)

- Organizuje, koordinira i usklađuje ukupan rad u operativnoj jedinici i radionici održavanja na regionalnom nivou;
- stara se o obezbeđivanju uslova za radnike u obavljanju poslova i zadataka i o punoj posvećenosti radnika u funkciji kontinuiranog pružanja usluga;
- Prati sprovođenje rasporeda rada u jedinici;
- daje predloge i uputstva za primenu naprednih standarda o javnoj higijeni i stara se o njihovoj primeni u praksi;
- Vodi širenje grada – uslužnog područja i prigradskih naselja i usklađuje planove usluga;
- U saradnji sa operativnim rukovodiocima sastavlja plan rada usluga i objavljuje ga;
- Prihvata izveštaje o radu od menadžera i ocenjuje ih i verifikuje;
- Proverava radne naloge, proslедуje i analizira evidenciju sa deponije;
- Zahteva nabavku delova i opreme za vozila, dozvoljava zahteve za rezervne delove iz magacina;
- Promoviše racionalno korišćenje tehničkih kapaciteta;
- Koordinira povezane radove i radnje između operativne službe i finansijske službe sa klijentom, radi povećanja kvaliteta usluga;
- obavlja i druge poslove na zahtev neposrednog rukovodioca;
- On/ona je odgovoran/a za svoj rad glavnom izvršnom direktoru;

Potrebne veštine: (veštine i veštine potrebne za ovaj posao)

- Odlučno i sveobuhvatno stručno poznavanje prava i javne uprave; Poželjno poznavanje engleskog jezika;
- Poznavanje dobrog rada na računaru korišćenjem programa (Microsoft Word, Excel, Power Point i dr.) i Interneta;
- Sposobnost pregleda različitih predmeta ili dokumenata svakodnevnog rada preduzeća;
- Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

Obrazovanje, stručna sprema i radno iskustvo: (potrebne kvalifikacije i iskustvo za ovaj posao)

- Univerzitetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva;

Konkurs je objavljen 21 avgusta 2023 godine i zatvara se 04 septembar 2023 godine.

APLIKACIJA: Uz prijavu se prilažu i potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

- Dokaz o školskoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu (Potvrda ili ugovor o radu);
- Dve preporuke (ako imate);
- Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o evaluaciji poslova (ako ih ima);
- Identifikacioni dokument – fotokopirano obaveštenje;
- Potvrda suda da niste pod istragom

NAČIN PRIMENE:

Obrazac prijave se prima i dostavlja u zatvorenoj koverti u arhivu KRM „Pastrimi“ S.A, ul. „Tahir Zajmi“, br. 5, Priština.

Prijava putem pošte: Prijava sa dokumentima se može dostaviti i poštom na adresu: Ul. "Tahir Zajmi", br.5, Priština, 10000. Prijave poslate poštom moraju biti obilježene poštanskim žigom poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig na pošiljci učinjenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u obzir ako stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu nakon ovog roka i one koje su nepotpune neće se uopšte razmatrati.

USLOVI UČEŠĆA U KONKURSU:

Svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, imaju neophodnu obrazovnu pripremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za dotičnu poziciju imaju pravo da se prijave.

KRM "Pastrimi" S.A nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja prijave svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

BELEŠKA:

NEKOMPLETNE PRIJAVE I DOKUMENTACIJA PREMA USLOVIMA NAVEDENIM U OVOM KONKURSU KAO I ONE PRISLEPE NAKON KONKURSNOG ROKA NEĆE SE RAZMATRATI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana, od dana objavljivanja.

Za važnije informacije možete se obratiti na br. telefon: +383 (0) 38 603 191

